



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:253097

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05711409

**A.C.nr.2482/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Bujar Muzaqi kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti, dhe Hysni Bardheci, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit G.N. me vendbanim në rr. "...", nr..., Komuna Ferizaj, të cilin e përfaqëson me autorizim Xh.A., avokat me seli në Komuna Ferizaj, kundër të paditurit R.Z. me vendbanim në rr. "...", Komuna Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim V.B., avokat me seli në Komuna Prishtinë, në çështjen kontestimore për kompensim të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurit, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm, C.nr.2472/14 datë 10.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.05.2024, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET pjesërisht** e themeltë ankesa e paditësit G.N. me vendbanim në rr. "...", nr..., Komuna Ferizaj, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm, C.nr.2472/14 datë 10.12.2020, dhe gjykohet si vijon: **PJESËRISHT APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit G.N. me vendbanim në rr. "...", nr..., Komuna Ferizaj, si e bazuar, **DETYROHET** i padituri R.Z. me vendbanim në rr. "...", Komuna Prishtinë, t'i paguaj paditësit G.N. me vendbanim në rr. "...", nr..., Komuna Ferizaj, në emër të kompensimit të dëmit, dhe atë për frikë të përjetuar shumen prej 1.050,00€uro (Njëmijëepesëdhjetë€uro), dhe për dhimbje trupore fizike shumen prej 1.400,00 €uro (Njëmijëekatërqind€uro), ndërsa pjesa tjetër përtej shumës së gjykuar për dhimbje trupore – fizike, dhe për frikë, **REFUZOHET E PABAZUAR**.

**II. REFUZOHET e pathemeltë** ankesa e paditësit dhe të paditurit, sa i përket vendosjes në pjesën tjetër të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm, C.nr.2472/14 datë 10.12.2020, dhe i njëjti, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.2472/14 datë 10.12.2020, ndër të tjera ka vendosur si vijon: “... I. **APROVOHET PJESËRISHT** kërkesëpadia e paditësit G.N. nga Ferizaj Rruga “...”, të cilin e me autorizim e përfaqëson avokati Xh.A., nga Ferizaj, ashtu që **DETYROHET** i padituri R.Z. nga Prishtina Rr. “...” –Lam. I-H-2, banesa nr.2, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokati V.B., që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, të shkaktuar nga i padituri, t’ia paguaj shumat si në vijim:

1. Në emër të dëmit jo-material:

- a) Për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshme jetësor shumën 1,000.00€.
- b) Për dhimbje fizike shumën 1,000.00€.
- c) Për frikë shumën 500.00€.

2) Në emër të dëmit material:

- a) Për ndihmën personit të huaj shumën 200€.
- b) Për ushqimin e përforcuar shumën 100€.
- c) Për shpenzimet e shërimit / trajtimit mjekësor shumën 200.00€ (dy qind euro ).  
apo në shumën e përgjithshme në vlerë 3,000.00€ ( Tremijë euro ), me kamatë si për mjete e deponuara në bankat e Kosovës, pa destinim të caktuar, e cila llogaritet nga data e marrjes së këtij aktgjykimi 10.12.2020 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**II. REFUZOHET** si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses për kompensimin e dëmit, përtej shumave të gjykuara si në pikën I të dispozitiviti të këtij Aktgjykimi.

**III. OBLIGOHET** e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore, në shumën prej 1033.50€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas marrjes – plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me përmbarim...”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë paditësi për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të miratohet ankesa e paditësit si e bazuar dhe të ndryshohet aktgjykimi dhe që shuma e dëmit material dhe jo material të miratohet në tërësi siç është përshkruar në precizimin e padisë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë i padituri, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit, që të aprovohet në tërësi ankesa të prishet aktgjykimi dhe

të hedhet poshtë padia ose të priset aktgjykimi dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesa nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

- **Ankesa e paditësit, është pjesërisht e bazuar.**
- **Ankesa e të paditurit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi G.N. me vendbanim në rr. "...", nr..., Komuna Ferizaj, ka paraqitur padi, kundër të paditurit R.Z. me vendbanim në rr. "...", Komuna Prishtinë, me kërkesë për kompensimin e dëmit.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 25.11.2020, dhe pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.2472/14 datë 10.12.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimin të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: *"... Sa i përket lartësisë së dëmit jo material, duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e lëndimeve trupore, si dhe duke marrë për bazë rrethana tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, sidomos rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit që shpërblimi të paraqet satisfacion për të dëmtuarin, gjykata miratoj pjesërisht kërkesëpadinë. Lidhur me lartësinë e dëmit material, duke pasur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pasur Paditësi, për Gjykatën është i besueshëm fakti se paditësi ka pasur nevojë për ndihmë nga personi i tretë, sidomos duke pasur parasysh moshën e tij, se i njëjti ka pasur nevojë për ushqim me proteina, minerale, vitamina si dhe shpenzime të shërim-it-trajtim-it mjekësor, andaj lartësinë e shpërblimit për dëmet në fjalë Gjykata i mbështeti në vlerësimin e saj të lirë bazuar në Nenin 323 të LPK-së të ndërlidhur me konstatimet mjekësore të ekspertëve..."*

Vlerësimin juridike të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullta dhe të bazuara në ligj pjesërisht i aprovon edhe kjo gjykatë, sepse aktgjykimin i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ku nuk ishte kontestuese baza juridike në këtë procedurë kontestimore, pasi që i padituri për lëndimin trupor të shkaktuar ndaj paditësit është shpallur fajtor me aktgjykimin PP.nr.5805/2012 datë 19.03.2013, i cili

aktgjykim nuk është kundërshtuar as nga i padituri, dhe as nga Prokurori, andaj Gjykata e Apelit vlerëson se gjendja faktike në këtë çështje është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen në këtë çështje juridike.

Gjykata e Apelit duke e marrë parasysh lëndimet e pësuar të paditësit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se shuma e kompensimit të dëmit të gjykuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë sa i përket kompensimit në emër të dëmit jo material për dhimbjet e pësuar, dhe për frikën e përjetuar, është e ultë andaj edhe e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar, duke gjykuar që paditësit G.N., nga Komuna Ferizaj, t'ia njoh në emër të dëmit jo material për dhimbje trupore shumë prej 1.400,00 Euro, (njëmijëekatërqindEuro), dhe për frikë shumë prej 1.050,00 (njëmijëepesëdhjetëEuro), duke u bazuar edhe në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve mjekësor Dr. V.B, ortopedë-traumatolog, dhe Dr. N.H., psikiatër të cilët në mendimin e dhënë kanë konstatuar se paditësi G.N., në incidentin e datës 10.08.2012, ka pësuar këto lëndime trupore: - Thyerje të krahut të djathtë, - Ndrydhje të regjionit të krahut të djathtë. Këto lëndime karakterizohen si lëndime të rënda trupore, i lënduari ka përjetuar dhembje fizike dhe atë : Dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë – 40 minuta duke përfshirë vendndodhjen e incidentit e deri realizimi dhe ekzaminimet klinike, radiologjike, dhe marrjes së analgjeticëve në QE si dhe vendosja e i mobilizimit në parakrahun e djathtë, dhembje fizike të intensitetit të rëndë 3 ditë, kohë pas kohe, deri në veprimin e terapisë, dhembje fizike të intensitetit të mesëm – 21 ditë kohë të nevojshme për konsolidim primar kockor dhe kohë e nevojshme për heqjen e hematomave, inflamacioneve post traumatike nën veprimin e terapisë si dhe kohë e nevojshme për rehabilitimin e indeve të lënduara, dhimbje fizike të intensitetit të ulët, ekspertet konstatojnë sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësin të cilat dhembje janë prezentë edhe sot e kësaj dite, me të shprehura gjatë sforcimeve fizike sidomos gjatë bartjes së peshës në dorën e djathtë. Paditësi përveç lëndimeve trupore, bazuar në të gjeturat e ekspertizës, Gjykata ka konstatuar se paditësi ka manifestuar edhe frikë dhe atë : 1.Frika primare e cila ka zgjatur disa sekonda dhe nënkupton momentin e aksidentit kohën brenda kësaj kohe ka përjetua ndjenjën e përfundimit fatal – frikë nga vdekja. 2. Frikë sekondare: a), të intensitetit të lartë, që ka zgjatur për 2 orë e manifestuar me frikë rreth dhënies së ndihmës së parë dhe frikë nga invaliditeti, b) të intensitetit mesatar e cila ka zgjat rreth gjashtë javë, e manifestuar me frikë, ankth çrregullime të gjumit dhe disponimit, rikujtime të herëpashershme të ngjarjes, shmangie të bisedave rreth ngjarjes, humbje të vullnetit, rënie të performancës në shkollë, c) të intensitetit të ulët, që ka zgjatur për 2 muaj, e manifestuar me simptomatologjinë e lartshënuar. Paditësi ka pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor për 2%, i njëjti ka pasur nevojë për ndihmë nga personi i tretë në kohëzgjatje prej 6 javësh, si dhe ka qenë në nevojë për ushqim të përforcuar prej 6 jave me proteina, minerale, vitamina për konsolidim më të shpejtë të frakturës. I njëjti ka pasur nevojë për rehabilitim-fiziko terapeutik në kohëzgjatje prej 10 ditësh, dhe se paditësi nuk ka pësuar shëmtim trupor. Në bazë të plotësisht të ekspertizës mjekësore, të datës 03.03.2020 është konstatuar se natyra e lëndimeve të paditësit në incidentin e datës 10.08.2012, konkretisht thyerja

e parakrahut të djathtë si dhe ndrydhja të regjionit të krahut të djathtë, klasifikohen si lëndime të rënda trupore.

Në nenin 323 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore në mënyrë decisive thuhet se *“Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë”*.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar si reale shumën sa i përket vendosjes së kompensimit të paditësit për ushqimin e përforcuar, ndihmës së personit, ku edhe e ka vërtetuar aktgjykimin e atakuar, pasi në bazë të mendimit të ekspertit mjekësor, i cili ka vlerësuar se paditësi G.N., ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar, në kohëzgjatje prej 6 jave, dhe ndihmën e personit në kohëzgjatje prej 6 jave, andaj këtë pjesë edhe e ka vërtetuar, si reale dhe të drejtë.

Në nenin 169 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në mënyrë decisive thuhet se *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”*.

Ndërsa në nenin 179 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndër të tjera thuhet se *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë”*.

Pretendimi ankimor i të paditurit se gjykata e shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është pretendim i pa bazuar pasi që dispozitivi i Aktgjykimit është i kuptueshëm, i kuartë dhe arsyetimi i Aktgjykimit përmban të gjitha faktet vendimtare, dhe arsyet pse është vendosë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të të paditurit, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d), dhe e), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**A.C.nr.2482/2021 datë 20.05.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari,**  
**Bujar Muzaqi**